

PROJEKTET NË ZBATIM THIRRJA E 5^{të}					
GRANTMARRËSIT: ORGANIZATA JO FITIM-PRURËSE					
Nr.	Organizata	Projekti	Përshkrim i Shkurtër	Kohëzgjatja (muaj)	Zona e Zbatimit
1	Instituti i Studimeve Politike (ISP)	Bashkitë e Qarkut Tiranë: Transparenca, qeverisja qytetare dhe llogaridhënia	Projekti synon të kryejë monitorimin aktiv, horizontal, krahasues dhe cilësor, mbi përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga kreu IV dhe VI dhe VII të ligjit 139/2015 - bilanci, risitë dhe sugjerimet. Objektivi kryesor është të krijojë një sistem matës dhe analizë faktike mbi bilancin e qeverisjes vendore në pesë bashkitë e Qarkut Tiranë, referuar treguesve të përfshirjes qytetare në vendimmarrje, transparencën publike, llogaridhënien nga të zgjedhurit, përfaqësimin urban-rural.	9	Bashkitë Kamëz, Kavajë, Rrogozhinë, Tiranë, Vorë
2	Qendra "Eduaktiv"	Liberi (latin: fëmijë)	Projekti synon aksesin dhe transparencën në informacionin e domosdoshëm që u nevojitet prindërve për përzgjedhjen e çerdhes dhe kopshtit për fëmijët e tyre, duke u dhënë një mekanizëm përmes të cilit jo vetëm të kenë akses në informacion por edhe të mund të ndikojnë në rritjen e presionit qytetar dhe evidentimin e problematikave në një grup më të gjërë shoqëror përfshirë edhe pushtetin vendor. Objektivi kryesor është ndërtimi i një platforme online (eduaktiv.al), ku do të listohen të gjitha informacionet e nevojshme publike, për çdo çerdhe dhe kopsht në mënyrë që një prind të ketë akses dhe transparencë në informacionin që u nevojitet për të bërë përzgjedhjen e çerdhes dhe kopshtit për fëmijët e tyre.	9	Projekt Kombëtar

3	Instituti për Kontratën Shoqërore	Qeverisja komunitare: sfidat e funksionimit të mekanizmave për pjesëmarrjen qytetare në Qarkun Korçë	Projekti synon të kontribuojë në përmirësimin e performancës së qeverisjes vendore në Qarkun Korçë përmes vënies në funksionim me efektivitet dhe në mënyrë inovatore të mekanizmave për pjesëmarrjen qytetare në nivel të qeverisjes vendore. Objektivat kryesorë janë: identifikimi i përparimit dhe boshllëqeve në zbatimin e ligjit organik lidhur me qeverisjen komunitare në nivel të qeverisjes vendore në Qarkun Korçë, si dhe ngritja e një rrjeti funksional të aktorëve vendorë për të marrë pjesë në mënyrë efektive në mekanizmat e qeverisjes komunitare në Qarkun e Korçës.	9	Bashkitë Korçë, Devoll, Maliq, Pogradec, Pustec, Kolonjë
4	Qendra për Nxitjen e Zhvillimit Njerëzor (HDPC)	Përmirësimi i mbulimit dhe cilësisë së shërbimeve për qytetarët e zonave rurale/periferike të Qarkut të Elbasanit si produkt i pjesëmarrjes dhe kontributit qytetar	Projekti synon të ndërgjegjësojë qytetarët në zonat periferike/rurale për shërbimet e bashkive/njësive për të nxitur pjesëmarrjen në monitorimin e aksesit, cilësisë dhe impaktit të shërbimeve duke kontribuar kështu aktivisht në përmirësimin e tyre në kohë. Objektivat kryesorë janë analiza e detajuar e shërbimeve (mbulim, akses, cilësi e impakt) në zonat periferike/rurale dhe krijimi i sistemit monitorues me pjesëmarrje për shërbimet bashkiake në këto zona duke përfshirë instrumente që masin shërbimet, perceptimin për to dhe kontributin qytetar duke ndikuar kështu në performancën e qeverisjes lokale.	9	Bashkitë Belsh, Cërrik, Elbasan, Gramsh, Librazhd, Peqin, Prrenjas

5	Qendra Shqiptare për Zhvillim dhe Integrim	Presioni qytetar mbi pushtetin vendor për shfrytëzimin e burimeve natyrore në dobi të komunitetit	Projekti synon në përdorimin e plotë 5% të rentës minerare në dobi të komunitetit dhe transparencën e plotë të përdorimit të saj për publikun. Objektivi kryesor është monitorimi qytetar i alokimit dhe përdorimit të rentës minerare gjatë dy viteve të fundit në 5 Njësitë e Qeverisjes Vendore për një periudhë 6 mujore.	6	Bashkitë Bulqizë, Has, Patos, Roskovec, Ura Vajgurore
6	Qendra ACEG	Barometri i Bashkisë Devoll. Matja e premtimeve lokale sipas nenit 27. Funkcionet e bashkisë në bujqësi, zhvillim rural dhe pyje	Projekti synon në matjen e realizimit të premtimeve sipas funksionit 27 dhe identifikimin e prioriteteve zhvillimore vendore për programin para-elektoral 2019 përmes angazhimit real të banorëve. Objektivat kryesorë janë matja e zbatimit të premtimeve zhvillimore në Bashkinë Devoll për harkun kohor 2015-2018 dhe forcimi i aktivizimit të banorëve përmes identifikimit të prioriteteve zhvillimore dhe lobimit në të paktën 5 sektorë kryesorë si bujqësi, pyje, zhvillim rural, mjedis dhe turizëm.	9	Bashkia Devoll
7	Shoqata për Trashëgimi dhe Edukim	Lëviz për të votuar	Projekti synon të nxisë të rinjtë në identifikimin dhe prioritizimin e nevojave të tyre reale që janë pjesë e kompetencave të bashkive. Objektivi kryesor i tij është hartimi i prioriteteve të të rinjve në bashkinë Durrës si bazë advokimi për fushatën elektorale të vitit 2019.	9	Bashkia Durrës
8	Qendra Kombëtare për Studime Sociale	Ju qeverisni – Ne monitorojmë	Projekti synon të fuqizojë kapacitetet e komunitetit (qytetarët, shoqërinë civile) në monitorimin dhe matjen e performancës së funksioneve të deleguara të qeverisjes vendore. Objektivi kryesor është monitorimi dhe vlerësimi i funksioneve të deleguara të pushtetit vendor (ndihma ekonomike, aftësia e kufizuar, shërbimet sociale dhe arsimit parashkollor) nga këndvështrimi i komunitetit.	9	Bashkitë Has, Kukës, Tropojë

9	Kujdesi Shëndetësor Familjar	Monitorimi i standarteve fizike të qendrave shëndetësore/ambulancave në Bashkitë Korçë, Devoll, Kolonjë	<p>Projekti synon të rrisë përgjegjësinë sociale të autoriteteve vendore përgjegjëse të bashkive Korçë, Devoll dhe Kolonjë për të siguruar infrastrukturë brenda standarteve të qendrave shëndetësore/ambulancat.</p> <p>Objektivi kryesor është monitorimi i standarteve fizike dhe i pajisjeve të 219 qendrave shëndetësore/ambulancave në tre Bashkitë respektive, Korçë, Devoll dhe Kolonjë.</p>	9	Bashkitë Devoll, Kolonjë, Korçë
10	Qendra për Zhvillim Komunitar "Sot për të Ardhmen"	Monitorimi i situatës shëndetësore të fëmijëve 0-6 vjeç në Bashkinë Durrës	<p>Projekti synon rritjen e ndërgjegjësimit të Bashkisë Durrës dhe aktorëve lokalë ndaj shërbimeve dhe kujdesit shëndetësor për fëmijët e moshës 0-6 vjeç. Objektivat kryesorë janë: monitorimi i shërbimeve të ofruara dhe buxheteve të alokuara në Bashkinë Durrës për shëndetin e fëmijëve të moshës 0-6 vjeç; ndërgjegjësimi i politikë-bërësve vendorë, këshillit bashkiak dhe qytetarëve për politika më të mira për shëndetin e fëmijëve 0-6 vjeç, si dhe integrimi i planit të detajuar të ndërhyrjes për shërbime cilësore në nivel lokal për shëndetin e fëmijëve 0-6 vjeç në planin social vendor.</p>	9	Bashkia Durrës
11	Shoqata Vizion Gruaje	Zhvillimi ekonomik i Skraparit – sfida e pushtetit vendor dhe e qytetarëve	<p>Projekti synon të monitorojë aksesin, mbulimin, cilësinë dhe impaktin e ushtrimit të funksioneve të Bashkisë në fushën e zhvillimit ekonomik vendor duke stimuluar produktet-‘brand’ dhe biznesin e vogël e të mesëm që gjenerojnë vende pune dhe zhvillim. Objektivi kryesor është ndërgjegjësimi i qytetarëve dhe promovimi i aksionit qytetar për t’u kërkuar dhe për t’i detyruar të zgjedhurit vendorë të ushtrojnë me efikasitet funksionet e tyre organike në fushën e zhvillimit ekonomik vendor.</p>	9	Bashkia Skrapar

12	Qendra për Studim & Trajnim ILLUMINATOS	Ujitja dhe kullimi jetike për fermerët	Projekti synon të monitorojë aksesin, mbulimin, cilësinë, impaktin e shërbimit të Ujitjes/Kullimit në NJA-të rurale në 3 bashkitë e Qarkut të Tiranës për të verifikuar efektet e zbatimit të ligjit 139/2015 në optikën qytetare. Objektivat kryesorë janë: angazhimi qytetar për të kërkuar sigurimin e shërbimit publik të ujitjes/kullimit nga pushteti vendor dhe ushtrimi i presionit ndaj 3 bashkive (Tiranë, Vorë e Kamëz) për të përmirësuar shërbimin e ujitjes dhe kullimit në 16 njësi administrative rurale.	9	Bashkitë Kamëz, Tiranë, Vorë
13	Qendra Media dhe Çështjet Shoqërore	Pyet qytetarin	Projekti synon t`ju ofrojë forcave politike një panoramë të qartë të kërkesave të banorëve të 5 Njësi Administrative të Tiranës, bazuar në problematikat e deritanishme. Objektivat kryesorë janë identifikimi i problematikave nga pikëpamja e qytetarëve për investimet kryesore që janë bërë në 5 njësi administrative të Tiranës si dhe të orientojë forcat politike mbi prioritetet që do të përcaktojnë për investime për zgjedhjet 2019.	8	Bashkia Tiranë
14	Shoqata “Mbrojtja e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara” (MEDPAK)	“Unë votoj dhe kam të drejtë të dëgjohem”	Projekti synon aftësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre për tu bërë pjesë e vendimmarrjes lokale, duke marrë pjesë në mbledhjet e këshillave bashkiake dhe takimet në komunitet të organizuara në periudhën para-elektorale të zgjedhjeve vendore 2019. Objektivat kryesorë janë: rritja e kapaciteteve të një grupi prej 35 personash për të ndërmarrë fushata ndërgjegjësimi dhe të advokojnë për të rritur pjesëmarrjen e PAK në votime, si dhe të përfshihen vetë PAK dhe familjarët e tyre në monitorimin e Planeve sociale të bashkive.	9	Bashkitë Belsh, Cërrik, Elbasan, Gramsh, Librazhd, Peqin, Prrenjas

15	Albanian Center for Quality Journalism	Tiranalytics: Një vlerësim i shpenzimeve publike të qeverisjes vendore në Bashkinë e Tiranës	Projekti synon të rrisë ndërgjegjësimin e qytetarëve të Tiranës mbi metodën dhe mënyrën e zhvillimit të investimeve publike nga Bashkia Tiranë. Objektivat kryesorë janë realizimi i një raporti hulumtues për 10 investime në infrastrukturën urbanistike publike të kryera nga autoriteti kontraktues Bashkia Tiranë si dhe i 10 artikujve të thelluar të gazetarisë hulumtuese dhe analitike mbi këto investime, ku do të përfshihen të gjithë hallkat e konceptimit, planifikimit, miratimit dhe implementimit të këtyre të fundit.	8	Bashkia Tiranë
16	SHOQATA “ANTIK”	Instalacion: Ndal ndotjes në Fier!	Projekti synon të rrisë ndërgjegjësimin dhe angazhimin qytetar për të kërkuar nga pushteti vendor të ushtrorë funksionet e veta për sigurimin e masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja. Objektivi kryesor është përdorimi i artit të instalacionit si mjet inovativ për ndërgjegjësimin e qytetarëve për të kërkuar të drejtat e tyre për jetë të shëndetshme.	9	Bashkia Fier
17	New Bridges Berat	Të rinjtë si faktorë ndryshimi në komunitet	Projekti synon të forcojë demokracinë vendore përmes pjesëmarrjes dhe aktivizimit qytetar në periudhën para-elektorale të zgjedhjeve vendore 2019 në Bashkinë Berat. Objektivat kryesorë janë monitorimi i premtimeve elektorale të vitit 2015 në fushën e mbështetjes për të rinjtë dhe ballafaqimi me pushtetin vendor, brenda 5 muajve dhe hartimi i kontratës sociale me prioritetet e të rinjve për 5 njësitë administrative të bashkisë Berat si një mjet advokimi për fushatën zgjedhore të 2019.	9	Bashkia Berat

18	Instituti Agenda	Shtirirje e Instrumentit Online të Pjesëmarrjes Qytetare buxhetim.al në 20 bashki të vendit	Projekti synon të rrisë ndikimin direkt të qytetarëve në hartimin e buxhetit të bashkive. Objektivat kryesorë janë instalimi dhe funksionimi i platformës online për buxhetimin me pjesëmarrje në 20 bashki si dhe rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve (sidomos të rinjve) në buxhetimin vendor.	7	20 Bashki
19	ECAT Tirana, Qendra Mjedisore per Administrim dhe Teknologji (Environmental Center for Administration and Technology)	Gjiri i Vlorës: Bukuria përballë ndotjes e larg vëmendjes	Projekti synon të monitorojë shërbimet e pushtetit lokal për pastrimin e ndotjes detare në Gjirin e Vlorës, të sensibilizojë komunitetin lokal dhe të advokojë e llojë për shërbime më të mira. Objektivat kryesorë janë: evidentimi dhe monitorimi i hendekut ekzistues mes kërkesës ligjore për pastrim dhe pastrimit faktik të kryer nga bashkia e Vlorës në bregdet, vlerësimi i ndotjes detare nëpërmjet metodave bashkëkohore, sensibilizimi i grupeve të interesit dhe mediave për cilësinë e shërbimit të pastrimit, si dhe ngritja e kapaciteteve advokuese të të rinjve për përmirësimin e këtij shërbimi në zonën detare e bregdetare.	12	Bashkia Vlorë
20	ART KONTAKT	ArtiVizëm për demokraci lokale të përgjegjshme	Projekti synon të stimulojë aktivizmin dhe angazhimin qytetar për të advokuar për problematikat lokale përmes aktivizmit artistik (ArtiVizëm). Objektivi kryesor është ushtrimi i presionit pranë Bashkisë Tiranë nga qytetarët e Njësisë Administrative nr. 2 të Tiranës për mbajtjen e premtimeve elektorale nëpërmjet artit, si dhe evidentimi i problematikave dhe premtimeve elektorale në Njësinë Administrative 2, Tiranë.	9	Bashkia Tiranë

21	Qendra për Zhvillim dhe Integrim Rajonal	Monitorim mjedisor në procedurat e prokurimeve të Bashkisë Korçë, Ersekë, Maliq	Projekti synon në mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet prokurimeve publike në bazë të legjislacionit në fuqi dhe përafrimit të legjislacionit me Direktivat e BE. Objektivat kryesorë janë monitorimi i prokurimeve për respektimin e standarteve mjedisore sipas legjislacionit në fuqi për vitet 2015-17 për Bashkinë e Korçës, Maliqit, Ersekës si dhe mobilizimi dhe ndërgjegjësimi i shoqërisë civile (në veçanti organizatave mjedisore dhe të shëndetit) për advokim/lobim për praktikën e “Green Procurement” në tri bashkitë ku shtrihet projekti.	12	Bashkitë Korçë, Ersekë, Maliq
22	Qendra e Bashkëpunimit Ndërfetar Elbasan – QBNFE	Fetarët ushtrojnë e nxisin demokraci aktive komunitare - <i>Fundak</i>	Projekti synon të nxisë, ngrejë dhe rrisë bashkëpunimin midis vendimmarrësve të ardhshëm dhe komuniteteve të besimtarëve, dhe jo vetëm atyre, për forcimin e zërit qytetar në qeverisje, duke u organizuar në grupime e forume sa më të mëdha qytetare. Objektivi kryesor është identifikimi dhe evidentimi i nevojave të komuniteteve në Elbasan, Belsh, Cërrik dhe hartimi i listave me prioritetet të cilat do t’u adresohen kandidatëve për kryebashkiak dhe atyre për këshilltarë vendorë në Zgjedhjet Vendore 2019.	9	Bashkitë Belsh, Cërrik, Elbasan
23	Qendra e Studimeve dhe Zhvillimeve	“Jo në rrugë, jo buzë përrenjve dhe lumit, jo çdo njësi me landfillin individual, për një mjedis të pastër, për një jetë të shëndetshme”	Projekti synon të kryejë monitorimin dhe vlerësimin e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve. Objektivi kryesor është krijimi i një manuali për monitorimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në tre bashki nëpërmjet përfshirjes së qytetareve.	9	Bashkitë Dropull, Gjirokastër, Tepelenë

24	Qendra për Kërkime sociale në cilësinë e shëndetit - "QKSCSH"	Forume Qytetare	Projekti synon rritjen e pjesëmarrjes qytetare nëpërmjet organizimit të forumeve në 12 njësi vendore të Bashkisë Tiranë. Objektivi kryesor është përballja e qindra qytetarëve me përfaqësuesit e 12 Njësive Administrative urbane të Tiranës për premtimet elektorale, me fokus të veçantë në fushën e menaxhimit të mbetjeve urbane.	9	Bashkia Tiranë
25	Gruaja Vizioni i Ndryshimit	Aktivizimi i mekanizmave të pjesëmarrjes së grave në procesin e vendimmarrjes, nëpërmjet formalizimit të grupeve lokale për zhvillim	Projekti synon të rrisë pjesëmarrjen e grave të zonave rurale në proceset vendimmarrëse në nivel lokal. Objektivat kryesorë janë krijimi i 5 grupeve lokale të grave në 5 Njësi Administrative si dhe nxitja e mekanizmave të komunikimit mes të zgjedhurve vendorë (Këshillit Bashkiak, Kryetar fshati, Administrator) dhe komunitetit.	8	Bashkia Lezhë
26	Shoqata Ekspertët e Rinj Mjedisor	Monitorimi dhe vlerësimi i ofrimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Bulqizë	Projekti synon të përmirësojë gjëndjen aktuale të shërbimit të pastrimit në Bashkinë Bulqizë dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve për mbajtjen pastër të qytetit ku jetojnë. Objektivat kryesorë janë realizimi i një monitorimi qytetar për cilësinë e shërbimit të pastrimit në Bashkinë Bulqizë si dhe i një fushate sensibilizimi.	9	Bashkia Bulqizë
27	Qendra për Zhvillim dhe Integrim - CDI	MOB KIT PËR TRANSPARENCË - Monitorimi i performancës së Bashkive dhe Këshillave në qarkun Kukës si instrument për rritjen e aksesit, mbulimit dhe impaktit të shërbimeve në NJ/A periferike dhe rurale	Projekti synon të përmirësojë Qarkun Verilindor në Kukës me anë të një procesi monitorimi që zbut disbalancën dhe ndihmon rritjen e performancës së qeverisjes vendore duke rritur efektivitetin e shërbimeve edhe në zonat rurale. Objektivi kryesor është përmirësimi i ofrimit të shërbimeve dhe investimeve që janë funksione të njësive të qeverisjes vendore ndaj qytetarëve të 10 njësive periferike të qarkut (sipas përcaktimeve të neneve 23-29 të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore").	9	Bashkitë Has, Kukës, Tropojë

PROJEKTET NË ZBATIM THIRRJA E 5^{të}

GRANTMARRËSIT INDIVIDË

Nr.	Individi	Projekti	Përshkrim i Shkurtër	Kohëzgjatja (muaj)	Zona e Zbatimit
28	Roland Beqiraj	Dy liqene nën një fokus	Projekti synon të sensibilizojë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe konkrete, komunitetin e bashkive Pogradec dhe Pustec për të reaguar në mbrojtje të mjedisit të përbashkët. Objektivat kryesorë janë mobilizimi dhe angazhimi i të rinjve për të rritur presionin ndaj bashkive respektive në mënyrë që t'i marrin seriozisht problematikat mjedisore si dhe të verë në lëvizje instrumentat përkatës të pushtetit vendor, por edhe institucionet e tjera që ligji i ngarkon për mbrojtjen dhe menaxhimin e problematikave mjedisore.	3	Bashkitë Pogradec, Pustec
29	Abdulla Diku	Vlerësimi i cilësisë së mjedisit përmes monitorimit të ajrit, ujit dhe tokës në qytetin e Elbasanit	Projekti synon të garantojë cilësinë e jetës, përmes vlerësimit të parametrave mjedisorë (ajri, uji, toka) për banorët e qytetit të Elbasanit. Objektivat kryesorë janë: të vlerësohet cilësia e mjedisit në qytetin e Elbasanit dhe zonat në afërsi të ish-metalurgjikut, si dhe të informojë komunitetin dhe autoritetet në nivel vendor e qendror lidhur me cilësinë e mjedisit dhe dhënien e rekomandimeve përkatëse.	8	Bashkia Elbasan
30	Anxhela Nurka	Biblioteka e munguar	Projekti synon të advokojë mbi mungesën e një biblioteke në Bashkinë Përmet përmes aktivizmit rinor. Objektivi kryesor është advokimi përmes aktivizmit rinor, në bashkinë Përmet mbi buxhetimin për rikonstruksionin e bibliotekës së qytetit.	8	Bashkia Përmet

31	Behar Dema	Të pastrojmë Maqellarën. Advokaci komunitare për ofrimin e shërbimit të pastrimit të mbetjeve urbane në Njësinë Administrative Maqellarë, Bashkia Dibër	Projekti synon të kontribuojë në mobilizimin e komunitetit të Njësisë Administrative Maqellarë për të influencuar pozitivisht në përmirësimin e ofrimit të shërbimit të pastrimit të mbetjeve urbane. Objektivat janë: Rritja e pjesëmarrjes së komunitetit të 22 fshatrave të Njësisë Administrative Maqellarë në përmirësimin e shërbimit të pastrimit duke advokuar pranë organeve dhe strukturave vendimmarrëse të Bashkisë Dibër brenda vitit 2018.	9	Bashkia Dibër
32	Sashen Rexhepaj	Infrastruktura e rrugëve rajonale të qytetit të Vlorës	Projekti synon të monitorojë investimet për përmirësimin e infrastrukturës së rrugëve rajonale. Objektivat kryesorë janë: monitorimi i kontratave të rrugëve të implementuara ose të planifikuara në projekt-buxhetin 2018-2020 për UB 14-15-16 (Vlore-18i) dhe 15 fshatra në Bashkinë Vlorë, si dhe ndërgjegjësimi qytetar për pjesëmarrje aktive në vendimmarrje dhe advokim për të realizuar shërbimet publike infrastrukturore për UB 14-15-16 (Vlore-18i) dhe 15 fshatra në Bashkinë Vlorë.	6	Bashkia Vlorë
33	Klaudio Hyseni	Durrësi aktiv për një bregdet të pastër	Projekti synon të nxisë aktivizmin qytetar në vendimmarrjen e pushtetit lokal në zgjidhjen e problemit të derdhjes së ujrave të zeza në Shëtitoren "Taulantia" lagjja nr.1, zona: Port - Currila plazh. Objektivat kryesorë: janë rritja e presionit publik ndaj pushtetit vendor përmes nxitjes së katër aksioneve të aktivizmit qytetar, si dhe përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe medias digjitale si mjete për të lobuar dhe zgjidhur problemin e derdhjes së ujrave të zeza në bregdetin e shëtitores Taulantia.	6	Bashkia Durrës

34	Anila Boshnjaku	Qeverisja me pjesëmarrje për të rritur cilësinë e dialogut dhe monitorimit të planeve të menaxhimit të Parkut Kombëtar Llogara	Projekti synon të promovojë qeverisjen me pjesëmarrje në funksion të përmirësimit të dialogut të grupeve të interesit të komunitetit lokal me institucionet vendore për një menaxhim cilësor të Parkut Kombëtar Llogara. Objektivat kryesorë janë: evidentimi i problematikave që lidhen me pjesëmarrjen e komuniteteve dhe aktorëve në menaxhimin e Parkut, dhënia e rekomandimeve për institucionet vendore (Bashkia, Agjencia Rajonale e Zonave të Mbrojtura) mbi rrugët për përmirësimin e nivelit të pjesëmarrjes së tyre, si dhe fillimi dhe formalizimi i një platforme dialogu midis stakeholders nëpërmjet krijimit të forumit të tyre.	9	Bashkia Vlorë
35	Noljan Lole	Hapësira publike të sigurta për të gjithë: Respektimi i masave mbrojtëse për qentë (rrip dhe maska) në ambiente publike”	Projekti synon të informojë dhe ndërgjegjësojë qytetarët që mbajnë qen, që të përdorin të gjitha masat mbrojtëse të detyrueshme për mbrojtjen e jetës së qytetarëve që përdorin hapësirat publike. Objektivat kryesorë janë: qartësimi i kompetencave dhe ndërgjegjësimi i autoriteteve vendore dhe qendrore për zbatimin e ligjit dhe monitorimin e hapësirave publike, kryesisht në zonat e njohura ku shëtisin kafshët/qentë; Rritja e sigurisë së jetës së qytetarëve që shfrytëzojnë hapësirat publike, forcimi i zbatimit të kuadrit ligjor nga zotëruesit e kafshëve (qenëve), si dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësim të këtij kuadri ligjor.	9	Bashkia Tiranë
36	Aurora Konomi	Çfarë shpëtojmë - Na shpëton ne	Projekti synon që të bëjmë qytetin tonë, një vend më të jetueshëm, më të sigurtë dhe të këndshëm për veten tonë si dhe për ata që e vizitojnë për qëllime turistike apo punë. Objektivat kryesorë janë: identifikimi i të gjitha pusetave në qytet, kapakët e të cilave mungojnë, të arrihet në zëvendësimin e tyre, të sigurohet ruajtja dhe monitorimi i tyre si dhe të rehabilitohen dhe të kthehen në mjedise të përshtatshme dhe të pastra zona të ndotura të identifikuar në dy rajone të qytetit të Vlorës.	8	Bashkia Vlorë